

Shkodra, Oboti, Dajci edhe shumë fshatra e komuna në veri të Shqipërisë vazhdojnë të zgjerojnë hartën e zonave që ndodhen nën ujërat e dala nga lumenjtë apo nga liqenet.

[Kryeministri Berisha](#) në një mbledhje qeverie ka bërë të ditur shkakun e këtyre përmbytjeve. Prej shumë kohësh [Këshilli i Ministrave.org](#) po studion me kujdes profecitë e [Shën Doktorit një doktor historik siamez](#) që ka jetuar në vitet 2010 P.S. (para Saliut).

Falë ndihmës së pakursyer të prof.dr.kriptolog Sali Berishës, stërnip i [Shën Doktorit](#) u bë e mundur transkriptimi me sukses i profecive të tij ku është zbuluar se këto fatkeqësi natyrore ishin të parashikuara.

Në librin e profecive, faqe 55 shkruhet:

*Këmbëgjati i kuq do të përdhosë festën e shenjtë*

*Tempulli blu do të mbulohet me turp*

*Andaj, lotët tanë do të mbulojnë Shqipëri*

*Deri sa Këmbëgjati të gjunëzohet*

